



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 134, datë 28.07.2023

PËR

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “BANKA OTP ALBANIA” SH.A. PËR TË USHTRUAR
VEPRIMTARI BROKERIMI NË SIGURIME, NË KLASAT E JETËS DHE TË JOJETËS**

Në bazë dhe për zbatim të pikës 4, të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Licencimin e “Bankës OTP Albania” sh.a., për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime, në klasat e jetës dhe të jojetës;**
- 2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE